

**INFOSOFT SYSTEMS SH.P.K.**

Raporti i Audituesit të Pavarur

dhe

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

**PËRMBAJTJA**

<b>EMERTIMI</b>	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	3-4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	8
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020	9-32

## **RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR**

**Drejtuar: Ortakëve dhe Drejtuesve të shoqërisë "Infosoft Systems" sh.p.k.**

Rruja Murat Toptani, Gjergji Center,

Tiranë, Shqipëri

### **Opinion me rezervë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "Infosoft Systems" sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria") me NUIS J61820021C, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllt me këtë datë, si edhe një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë, me përashtim të efekteve të çështjeve të paraqitura në bazat për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllt në atë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### **Baza për Opinionin me rezervë**

#### **Llogari të arkëtueshme tregtare**

Shoqëria ka raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2020, në shenimin nr.5 "Llogari të arkëtueshme tregtare" me vlerë 769,675,267 Lekë (31 Dhjetor 2019: 1,244,000,352 Lekë). Nga procedura e nisur për marrjen e konfirmimeve me shkrim nga Klientët, ne kemi marrë përgjigje vetëm për 5.1 % të vlerës së kërkuar, ndërsa verifikuam me procedura alternative klientë me vlerë 304,700,207 Lekë. Për shkak të rëndësisë së vlerës së pa konfirmuar si dhe pamundësisë sonë përmes marrë evidencën e përshtatshme të auditimit të kërkuar per shkak te afateve te auditimit, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse duhet të ishin kryer veprime irregulluese dhe sa ishte efekti i tyre në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e fitimit ose humbjes apo në pasqyrën e flukseve të parasë të vitit të mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë pëershkuar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare" të këtij rapporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Profesionistëvë Kontabël i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël dhe me kërkesa etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evideanca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi i shoqërise, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qofitë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përvç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë

aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tonë janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-së do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njojje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmérinë e çmuarjeve kontabel dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabel të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedh dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundim që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në reportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tonë bazuhen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e rapportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, me qëllim të paraqitjes së drejtë të transaksioneve dhe ngjarjeve të periudhës kontabel, përfshirë këtij rapporti.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Vera LALA  
Auditues Ligjor  
Venis-Audit & Finance sh.p.k.  
Rr. "Fadil Rada", P. Rrugë-Ura, Ap.1, Sh.2,  
Tiranë, Shqipëri



Tiranë, më 01/04/2021

Valbona MERKO  
Auditues Ligjor  
N.J.B. nr.9, Rr. "Bardhok Biba", Pall. "LID"  
sh.p.k., katë IV, Ap. 22,  
Tiranë, Shqipëri

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shenime	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	4	113,193,194	104,547,886
Llogari të arketueshme tregtare	5	769,675,267	1,244,000,352
Inventari	6	69,435,684	167,700,493
Kostot e kontratave të shërbimit	7	35,394,039	89,952,321
Aktive të kontratës	8	89,868,360	204,132,360
Të arkëtueshme të tjera	9	34,468,047	37,247,187
Të arkëtueshme nga tatumet	25	5,874,208	30,273,659
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>1,117,908,799</b>	<b>1,877,854,258</b>
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	10	15,204,012	16,991,067
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>15,204,012</b>	<b>16,991,067</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>1,133,112,811</b>	<b>1,894,845,325</b>
<b>DETYSRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	11	381,699,556	671,621,263
Detyrime tatimore dhe të tjera	12	75,598,655	53,485,431
Detyrime kontrate	13	13,919,256	47,426,924
<b>Totali i detyrimeve afatshkura</b>		<b>471,217,467</b>	<b>772,533,618</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Divident i pagueshëm	14	0	0
Hua me interes nga palët e lidhura	15	193,000,000	445,045,120
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>193,000,000</b>	<b>445,045,120</b>
<b>TOTAL DETYSRIME</b>		<b>664,217,467</b>	<b>1,217,578,738</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali	16	67,400,000	67,400,000
Fitimi i pashpërndarë	16.1	401,495,344	609,866,587
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>468,895,344</b>	<b>677,266,587</b>
<b>TOTALI I DETYSRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>1,133,112,811</b>	<b>1,894,845,325</b>

Pasqyra e pozicionit finanziar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga nr.1 deri 30, bashkëlidhur.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Infosoft Systems Sh.p.k më datë 1 Shkurt 2021 dhe u firmosën nga:

Administrator  
Armand SHARA



Përgjegjës kontabiliteti  
Entela Leka

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

	Shenime	Viti 2020	Viti 2019
Të ardhura nga shitjet	17	2,287,123,310	2,387,900,730
Kosto e inventarit dhe e shembimeve te shitura	18	-1,408,104,223	-1,388,089,557
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>879,019,087</b>	<b>999,811,173</b>
 Të ardhura të tjera operative neto	 19	 1,634,419	 5,896,468
Shpenzime personeli	20	-186,432,126	-172,162,149
Shpenzime administrative	21	-73,096,615	-108,869,551
Shpenzimet e amortizimit	10	-4,127,027	-4,630,726
Shpenzimet e zhvlerësimit	22	-118,250,825	-15,735,355
<b>Fitimi operacional</b>		<b>498,746,913</b>	<b>704,309,860</b>
 Shpenzime financiare, neto	 23	 -31,780,499	 -27,073,213
Humbja nga kursi këmbimit, neto	24	-4,038,808	-1,837,995
<b>Të ardhura/shpenzime financiare, neto</b>		<b>-35,819,307</b>	<b>-28,911,207</b>
 Fitim/(Humbja) para tatimit	 16.11	 <b>462,927,606</b>	 <b>675,398,652</b>
Shpenzim për tatim fitimin e vitit	25	-61,432,262	-65,532,065
Shpenzim për tatim fitimin e shtyrrë			
<b>Fitim/(Humbja)</b>	<b>16.1</b>	<b>401,495,344</b>	<b>609,866,587</b>
 Të ardhura gjithpërfshirëse të tjera		 0	 0
<b>Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithpërfshirëse</b>	<b>16.1</b>	<b>401,495,344</b>	<b>609,866,587</b>

Kjo pasqyrë të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga nr.1 deri 30, bashkëlidhur.

Këto pasqyra financiare u aprovaan nga Drejtimi i Infosoft Systems Sh.p.k më datë 1 Shkurt 2021

**Administrator**  
**Armand SHARA**

**Përgjegjës kontabiliteti**  
**Entela Leka**



**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shënim	Kapitali	Fitimi i pashpërndarë	Total
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	16	<b>67,400,000</b>	<b>803,342,720</b>	<b>870,742,720</b>
Dividentë të paguar	14	-	(803,342,716)	(803,342,716)
Fitimi neto i viti	16.1	-	609,866,587	609,866,587
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	16	<b>67,400,000</b>	<b>609,866,591</b>	<b>677,266,591</b>
Dividentë të paguar	14	-	(609,866,591)	(609,866,591)
Fitimi neto i viti	16.1	-	401,495,344	401,495,344
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	16	<b>67,400,000</b>	<b>401,495,344</b>	<b>468,895,344</b>

Kjo pasqyrë të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga nr. 1 deri 30, bashkëlidhur.  
Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Infosoft Systems Sh.p.k. më datë 1 Shkurt 2021.

Administrator  
Armand SHARA

Përgjegjës kontabiliteti  
Entela Leka



**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

	Shënim	Viti 2020	Viti 2019
<b>Fitimi para tatimit</b>	16.11	<b>462,927,606</b>	<b>675,398,652</b>
<b>Rregullime per:</b>			
Amortizimin	10	4,127,027	4,630,726
Shpenzimet e interesit	23	21,830,802	25,451,539
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	19	95,721	68,349
Ndryshime ne zhvleresimin e llogarive te arketueshme		0	0
Ndryshime ne provigjonin per inventarin ne vleren neto	6	1,383,249	-3,281,047
Efekti nga rivlersimi i kurseve te kembimit	24	4,038,808	1,837,995
<b>Fitimi per aktivitetin operativ para ndryshimit ne kapitalin punues:</b>		<b>494,403,213</b>	<b>704,106,214</b>
 Renie/(rritje) ne llogarite e arketueshme	5	457,162,735	120,203,830
Renie/(rritje) ne llogarite e arketueshme me palet e lidhur	5	17,162,350	12,800,255
Renie/(rritje) ne llogarite e arketueshme te tjera	9	2,779,140	3,598,891
Renie/(rritje) ne inventar	6	265,703,842	-101,719,985
Renie/(rritje) ne llogarite e pagueshme	11	-209,474,760	164,914,885
Renie/(rritje) ne llogarite e pagueshme ndaj paleve te lidl	11	-78,093,897	59,693,777
Renie/(rritje) ne detyrimet te tjera	12	22,113,228	-12,486,167
Renie/(rritje) ne te ardhurat e shtyra	13	-33,507,668	-37,832,523
Tatim fitimi i pagueshem	25.1	-37,032,811	-63,576,945
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto gjeneruar nga veprimtaria e shfrytezimit</b>		<b>901,215,372</b>	<b>849,702,231</b>
 Blerje e aktiveve afatgjata materiale	10	-2,435,692	-3,064,296
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto I perdonur ne veprimtarite e investimit</b>		<b>-2,435,692</b>	<b>-3,064,296</b>
 Te hyra neto nga huate e paleve te lidhura	15	-252,045,120	324,515,920
Interes I paguar	23	-28,222,660	-18,516,878
Dividente te paguar	14	-609,866,591	-1,184,418,266
<b>Fluksi i mjeteve monetare neto perdonur ne veprimtarite e financimit</b>		<b>-890,134,371</b>	<b>-878,419,224</b>
 Rritje neto te mjeteve monetare dhe ekuivalente te tyre		<b>8,645,308</b>	<b>-31,781,289</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fillim te v	4	<b>104,547,886</b>	<b>136,329,175</b>
 <b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fund te vi</b>	4	<b>113,193,194</b>	<b>104,547,886</b>

Kjo pasqyrë të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga nr.1 deri 30, bashkëlidhur.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Infosoft Systems Sh.p.k më datë 1 Shkurt 2020.

Administrator  
 Armand SHARA

Përgjegjës kontabiliteti  
 Entela Leka



## SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DIJETOR 2020

### 1. INFORMACION MBI SHOQËRINË

Infosoft Systems Sh.p.k. ("Shoqëria") eshte Shoqeri me perjegjesi te kufizuar e regjistruar me 27 dhjetor 1995 ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes, bazuar ne vendimin nr.13209 dhe operon ne perputhje me ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" i ndryshuar.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është: Importi, eksporti dhe tregëtimi i pajisjeve IT të tipeve të ndryshme si hardware, software dhe të gjitha shërbimeve të lidhura me to si dhe të prodhimit/zhvillimit të software-ve.

Kapitali i paguar i Shoqërisë është 67,400,000 Lek, i ndarë ne 3(tre) kuota me vlerë të ndryshmë të kontributit.

Kuotat e pronësisë:

- Shoqëria "Investment Joti – Infosoft Group" sh.p.k., zoteruese e 1 (një) kuote, me vlerë 47,180,000 Leke, që përbën 70 % të kapitalit të regjistruar dhe të drejtës së votës në asamblenë e përgjithshme;
- Shoqëria "TAG Engineering" sh.p.k., zoteruese e 1 (një) kuote, me vlerë 13,480,000 Leke, që përbën 20 % të kapitalit të regjistruar dhe të drejtës së votës në asamblenë e përgjithshme;
- Z. Bledar Dhima, zoterues i 1 (një) kuote, me vlerë 6,740,000 Lek, që përbën 10 % të kapitalit të regjistruar dhe të drejtës së votës në asamblenë e përgjithshme.

Administrator: Z. Armand Shara, me të drejta, detyra dhe kufizim të kompetencave, sikurse është përcaktuar në statutin e shoqërisë, me afat emërimi deri me 20 Mars 2024.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është në: Rr.Murat toptani, Gjergji Center, Tirana, Shqipëri

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 87 punonjës (2019: 85 punonjës).

### 2. BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

#### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të përcaktuara nga SNRF-të për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura më poshtë. Te dhenat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, ne mënyre të vecante me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

#### 2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në "Lekë" e cila është moneda funksionale e shoqërisë.

#### 2.4 Klasifikimi afatgjatë kundrejt afatshkurtër

Shoqëria prezanton aktivet dhe detyrimet në pasqyrat e pozicionit finansiar bazuar në klasifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër. Një aktiv është afatshkurtër kur :



 

- Pritet të realizohet ose ka për qëllim të shitet ose konsumohet brënda ciklit normal të operimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- Pritet te realizohet brënda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit
- Është në formën e mjeteve monetare ose një ekivalenti të mjeteve monetare, me përashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

Të gjithë aktivet e tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur:

- Pritet që të shlyhet brënda ciklit normal të operimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- E ka afatin për tu shlyer brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit
- Njësia ekonomike nuk ka ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

Shoqëria klasifikon të gjitha detyrimet e tjera si afatgjatë. Aktivet dhe detyrimet tatuore të shtyra klasifikohen si afatgjatë.

## 2.5 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqerise ka kryer një vleresim te aftesise se shoqerise per te vazhduar aktivitetin ne vijimesi dhe eshte i kenaqur qe shoqeria ka burime per te vazhduar biznesin dhe aktivitetin ne te ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk eshte ne dijeni te ndonje pasigurie materiale qe mund te sjelle dyshime te konsiderueshme mbi mundesine e shoqerise per te vazhduar ne vijimesi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojne te perqatiten ne baze te parimit te vijimesise.

## 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKA MË TË RËNDËSISHME KONTABËL

### 3.1 GJYKIMET DHE VLERËSIMET

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësimë që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimiçht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjera, përfshirë edhe prishmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme për rrëthanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësimë. Rishikimet e vlerësimëve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

#### a. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen me shumën me të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme drejtimi vlerëson çmimet e prishme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesit të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

#### b. Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kostot të amortizuar në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 10. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.



**c. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuara që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme, eksperiencën historike, cilësinë e klientit dhe ndryshimet e ndodhura pas datës raportuese. Kjo përfshin supozime për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkçësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura me pare.

**d. Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Eshtë i nevojshem gjykimi per përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atij të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrimin ne rast te auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund te lindin si detyrim. Nese tatimi perfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do ndikojnë në vleren aktuale te aktiveve dhe pasiveve tatimore aktuale e të shtyra, në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

**e. Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Shoqëria nuk ka politika të rendësishmë kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese te miratuara prej saj, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare e jo financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar vetëm me qëllim të matjes dhe prezantimit. Drejtimi i shoqërisë vlerëson se vlera e drejtë parave, e llogarive të arkëtueshmë dhe të pagueshme, e aktiveve te tjera dhe detyrimeve te tjera afatshkurtër dhe e tatimit mbi fitimin, përafrohet me vlerën kontabile për arsyet e maturitetit afatshkurtër të ketyre instrumenteve.

### **3.2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

**f. Transaksionet në monedha të huaja**

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria. Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë:

Monedha	31.12.2020	31.12.2019
EUR/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

**g. Instrumentat financiarë**

Një instrument finansiar është çdo kontratë që krijon një aktiv finansiar dhe një pasiv finansiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, mjete monetare dhe të ngjashme, llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera, te arketueshme dhe te pagueshme.



#### **h. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare.**

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktiv finanziar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit finanziar.

Përveç illogarive të arkëtueshme tregtare brenda objektit të paragrafit 5.1.3 të IFRS 9, në njojhen fillestare, një njësi ekonomike do të matë një aktiv finanziar ose detyrim financiar me vlerën e drejtë të tij plus ose minus, në rastin e një aktivit finanziar ose detyrimi finanziar të përeactuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aktivit finanziar ose detyrimit financiar.

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e pasiveve financiare. Miratimi i SNRF 9 nuk ka pasur efekt të rendësishëm në politikat kontabël të Shoqerise, pasi shoqëria vijon të zhvillojë të njëtin model biznesi. Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimi me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, të tjera të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare te cilat janë të gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

#### **i. Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

SNRF 9 zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura në SNK 39 me një model të humbjes së pritshme të kredisë. Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, humbjet nga kreditë njihen më herët se në SNK 39. Për aktivet në kuadër të modelit të SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi zakonisht pritet të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme. Shoqëria ka analizuar portofolin e saj dhe vlerëson që rreziku i kreditit për aktivet financiare është rritur ndjeshëm që nga njojha fillestare, dhe si rrjedhim duhet të masë provisionin për humbjen e atij instrumenti financiar në një shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë për 12-muaj. Shoqëria vlerëson aktivet financiare mbi baza individuale dhe kolektive.

#### **j. Inventarët**

##### *Njojja dhe matja*

Inventarët e shoqerise perbehën nga mallra dhe materiale specifike per fushen e teknologjisë dhe informacionit, te cilat ose shiten ashtu sikurse blihen nga prodhuesit ose perdoren per realizimin e sherbimeve dhe te produkteve software, pra behen pjese e tyre, duke plotesuar kriteret e meposhtme si aktive:

- (a) të mbajtura për shitje në rrjedhën normale të biznesit;
- (b) në procesin e prodhimit për këto shitje; ose
- (c) në formën e materialeve apo furnizimeve që do konsumohen gjatë procesit të prodhimit ose ofrimit të shërbimeve.

Kosto e inventarëve përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar me çmuarje në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes. Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifat doganore dhe sigurimit gjate transportit, si dhe çdo kosto tjeter që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës. Kur inventarët shiten, vlera kontabël e tyre njihet si shpenzim në periudhën në të cilën njihen të ardhurat përkatëse.

##### *Zhvlerësimi i inventarëve*



Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve do të njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja. Shuma e ndonjë rimarrje të zhvlerësimit të inventarëve, që vjen nga tritja e vlerës neto të realizueshme, do të njihet si një zbritje e shumës së inventarëve të njojur si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rimarrja.

#### **k. Aktive afatgjata materiale**

##### *Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen me blerjen e aktivit si dhe çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdonimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e mepashme te vendndodhjes se aktivit (kur njësia është në këto kushte).

Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme. Ato kontabilizohen si zera te ndryshen (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerjet jashte perdonimit percaktohen duke krasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

##### *Kostot e mepashme*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdonimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdonur metodën zbrtese te amortizimit, mbi jeten e vleresuar te aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes, per te gjitha klasat e aktiveve afatgjata materiale. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi. Aktivet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

Me poshte janë normat e amortizimit te aplikuara nga Shoqeria per periudhën qe mbyllte me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019:

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e Amortizimit</b>
Instalime, impiante	Mbi vleren e mbetur	20%
Makineri dhe pajisje	Mbi vleren e mbetur	20%
Mjete transporti	Mbi vleren e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vleren e mbetur	20%
Pajisje Informatike	Mbi vleren e mbetur	25%
Asete te Tjera	Mbi vleren e mbetur	20%
Programe informatike	Mbi vleren e mbetur	25%

#### **L. Zhvlerësim i aktiveve jo financiare**

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përvèç aktiveve tatumore të shtyra, për të përcaktuar nese ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parase çshët vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës



në përdorim, skontohen fluksset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimin para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiv apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen ne pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

## **II. Aktive nga kontratat**

Të drejtat e arkëtueshme janë të drejta në këmbim të mallrave të shitura apo shërbimeve të dorëzura/pranuara të cilat janë transferuar tek klientët. Nëse Shoqëria ka bërë transferimin e mallrave, shërbime apo materialeve të nevojshme për realizimin e shërbimeve, më parë se shuma të jetë e detyrueshme për t'u faturuar apo paguar, atëherë njihen aktive nga kontratat me klientët për konsideratën e fituar që është e kushtëzuar.

Nëse ndonjëra nga palët në kontratë ka përfunduar pjesën e vetë, njësi ekonomike duhet të paraqesë kontratën në pasqyrën e pozicionit finanziar si një aktiv kontrate ose detyrim kontrate, në varësi të marrëdhënieς mes performancës së njësisë ekonomike dhe pagesës së klientit.

Nëse një njësi ekonomike vepron duke transferuar mallrat apo shërbimet tek një klient para se klienti të paguajë shumën korresponduese ose para se shuma të jetë e detyrueshme për t'u paguar, njësi ekonomike duhet të paraqesë kontratën si një aktiv kontrate, duke përjashtuar çdo shumë të paraqitur si llogari të arkëtueshme. Një aktiv kontrate është një e drejtë e njësisë ekonomike për shumën korresponduese në këmbim të mallrave apo shërbimeve që njësi ekonomike ka transferuar tek një klient. Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë një aktiv kontrate për zhvlerësim në përputhje me SNRF 9. Shoqëria ka njohur aktive nga kontratat per materialet e transferuara për të plotësuar detyrimet e kontrave me klientët e saj te shërbimeve.

## **m. Kostot për të realizuar një kontratë shërbimi**

Nëse kostot e ndodhura për realizimin e një kontrate me një klient nuk janë brenda objektit të ndonjë Standardi tjetër, Shoqëria duhet të njohë një aktiv nga kostot e ndodhura për realizimin e kontratës vetëm nëse këto kosto plotësojnë të gjitha kushtet në vijim:

(a) kostot lidhen drejtpërdrejt me një kontratë ose një kontratë të parashikuar, që njësi ekonomike mund të identifikojë në mënyrë specifike (për shembull, kostot e lidhura me shërbime që duhet të ofrohen nga rinnovimi i një kontrate ekzistuese ose kostot e përcaktimit të një aktivitës për transferim sipas një kontrate specifike, e cila nuk është miratuar ende);

(b) kostot krijojnë ose rrisin burime të njësisë ekonomike të cilat do të përdoren për të plotësuar (ose për të vijuar plotësimin) e kushteve të performancës në të ardhmen; dhe

(c) kostot pritet që të rikuperohen.

Shoqëria ka klasifikuar si aktiv, kostot e shërbimeve të blera me qëllim rishitje, për të plotësuar detyrimet e kontrave me klientët e saj në përputhje me paragrafin 91 ose 95 të SNRF 15.

## **n. Detyrime nga kontratat**

Detyrimet nga kontratat me klientët janë detyrime për të transferuar mallra apo shërbime tek klientët për të cilat Shoqëria ka marrë një parapagim. Një detyrim kontrate është një detyrim i njësisë ekonomike për të transferuar mallra apo shërbime tek një klient për të cilin njësi ekonomike ka marrë shumën korresponduese (ose ka të drejtë për një shumë korresponduese) nga klienti.

## **o. Llogaritë e arkëtueshme**

Një llogari e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë që është e pakushtëzuar (dmth., kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës). Referojuni politikave kontabël të aktiveve financiare në seksionin 3.9 Instrumentet financiare - njohja fillostarte dhe matja mëvonshme.

## **p. Provisionet**



Provizoni njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur ne përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigionet përcaktohen duke skontuar flusket e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

Provizonet rishikohen ne çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do te kërkohet për të shlyer detyrimin, provigioni anullohet. Provizonet përdoren vetëm për qëllimet e njoitura fillimisht. Provizonet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

#### **q. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përbëhen nga ortakët dhe drejtoret e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë apo kontrollohen, të cilët mund të ushtronin influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

#### **r. Parapagime per sherbime**

Parapagime per sherbimet janë njojur ne aktive ne masen e sherbimit te kontraktuar midis furnitorit dhe Shoqerise per kryerjen e sherbimeve te caktuara ne funksion te aktivitetit primar.

#### **s. Përfitimet e punonjësve**

Shoqëria paguan rregullisht kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shoqëria, në njedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet dhe sigurimin shendetesor në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhë të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

#### **sh. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga mjete monetare të kontribuara nga ortakët e shoqërisë. Kapitali mbahet në LEKË dhe njihet me vlerë nominale.

#### **t. Të ardhurat dhe kostot financiare**

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesit përfondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

#### **th. Kostot e huave**

Kostot e huave(linjave te kreditit) të lidhura direkt me plotesimin e nevojave të shoqërisë për kapital pune janë njojur në shpenzimet e periudhës kur ato kanë ndodhur, sipas normës së interesit efektiv, në raport me kohëzgjatjen dhe vlerën e huase se perdorur.

#### **u. Shpenzime për tatim fitimin**

Tatimi mbi fitimin nënkuption tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përvèc rasteve kur lidhen me zëra të njojur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatushëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

#### **v. Tatimi i shtyrë**



Tatimi i shtyrë njihet si diferenca e përkohshme mes vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës së tatushme korresponduese përdorur në llogaritjen e fitimit të tatushëm. Detyrimet e tatimit të shtyrë në përgjithësi llogariten për të gjitha diferençat e tatushme të përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë në përgjithësi njihen për të gjitha diferençat e zbritshme të përkohshme në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatushëm do të jetë i mundshëm në mënyrë që këto diferenca të zbritshme të përkohshme të mund të përdoren. Këto aktive dhe detyrime të tatimit të shtyrë nuk do të njihen në qoftë se këto diferenca rezultojnë nga njofta fillostarë e aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk prek as fitimin e tatushëm, as fitimin kontabël.

#### y. Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përvçëse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

#### z. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigionin. një detyrim njihet ne datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet ne mënyrë të besueshme.

#### zh. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet irregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime irregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

### 3.3 STANDARDE DHE INTERPRETIME TË REJA TË APLIKUESHME PËR PËRIUDHËN QË MBULOJNË KËTO PASQYRA FINANCIARE

#### 3.3.1 SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientet

IFRS 15 krijon një kuadër gjithpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendësoi SNK 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe interpretimet përkatëse. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen sipas një modeli me pese hapa, kur një klient merr kontrollin e mallrave ose shërbimeve. Përaktimi i kohës së transferimit të kontrollit - në një moment ose përgjatë një kohëzgjatje - kërkon gjykim. Shoqëria ka aplikuar SNRF 15, që në datën e aplikimit fillostar (dmth. 1 Janar 2018) pa ndonjë efekt në periudhat krahasuese.

Shoqëria aplikoi gjykimet vijuese të cilat në mënyrë të rëndësishme ndikojnë vendosjen e shumës dhe kohës së njoftes së të ardhurave nga kontratat me klientët.

Shoqëria operon në fushën e importit, eksportit dhe tregetimit të pajisjeve IT te tipeve te ndryshme si hardware, software dhe të gjitha shërbimeve te lidhura me to. Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve i transferohet klientit në një shumë cila pasqyron shumën që Shoqëria pret në këmbim të transferimit të këtyre mallrave ose shërbimeve për një klient.

#### Shitia e pajisjeve hardware

Të ardhurat nga shitja e pajisjeve hardware njihen në momentin kur kontrolli i pajisjeve i transferohet klientit, zakonisht me anën e një fature tregtare për pajisjen hardware. Afati normal i kredisë është 30 në 60 ditë pas dorëzimit.



Shoqëria merr në konsideratë nëse ka premtimë të tjera në kontratë që janë kushte të veçanta të performancës, për të cilat duhet të ndahet një pjesë e çmimit të transaksionit (p.sh., garancitë). Në përcaktimin e çmimit të transaksionit për shitjen e pajisjeve, Shoqëria merr parasysh efektet e shumës së ndryshueshme, ekzistencën e komponentëve të rëndësishëm të financimit etj (nëse ka).

### **Detyrimet e Garancisë**

Shoqëria, në mënyrë tipike, siguron garanci për riparime të zakonshme të difikteve që ekzistonin në kohën e shitjes, siç kërkohet nga praktikat tregtare. Këto garanci të ngjashme me sigurimet, janë të përfshira nën SNK 37 Provizonet, Detyrimet kontabël dhe aktivet e kushtëzuara. Referojuni politikës së kontabilitetit për provisionet e garancisë në seksionin Provizonet.

Shoqëria siguron një garanci një-vjeçare përtëj rregullimit të dëmtimeve që ekzistonin në kohën e shitjes. Këto garanci të tipit të shërbimeve shiten së bashku ose më vete nga shitja e pajisjes hardware.

Kontrata e përbashkëta të shitjes së pajisjeve dhe garancisë së tipit shërbim, përbajnjë dy kushte të performancës sepse premtimet për të transferuar pajisjet dhe për të siguruar garancinë e tipit shërbim, janë të dallueshëm. Duke përdorur metodën e çmimit të shitjes më vete, një pjesë e çmimit të transaksionit i ndahet garancisë së tipit shërbim dhe njihet si një detyrim i veçantë i performances. Të ardhurat njihen gjatë periudhës në të cilën garancia e tipit shërbim mundësohet, pra gjatë kohës.

### **Shërbimet e Instalimit**

Shoqëria ofron shërbimet instalimit, që shiten veçmas ose së bashku me pajisjen hardware. Shërbimet e instalimit mund të merren nga ofruesit e tjerë dhe nuk rregullojnë ose modifikojnë në mënyrë të konsiderueshme pajisjen. Kontratat për shitjet e përbashkëta të pajisjeve hardware dhe shërbimeve të instalimit janë të përbëra nga dy kushte të performancës pasi premtimi i transferimit të pajisjes hardware dhe shërbimeve të instalimit janë të afta të janë të dallueshëm dhe lehtësishët të identifikueshëm. Si rrjedhojë, Shoqëria alokon çmimin e transaksionit bazuar në çmimet relative të shitjes së pavarur të pajisjeve dhe shërbimeve të instalimit.

Shoqëria njeh të ardhura nga shërbimet e instalimit në momentin kur testet e instalimit përfundojnë me sukses. Të ardhurat nga shitja e pajisjeve hardware njihen zakanisht në momentin që kryhet dorëzimi i pajisjes hardware.

### **Shërbimet e mirembajtjes dhe prodhimi i programave**

Shoqëria siguron shërbime që shiten veçmas, si mirembajtje e pajisjeve hardware dhe software si dhe prodhimi i programave informatike. Shoqëria njeh shërbimet si një kusht të vetëm të performancës dhe njeh të ardhurat gjatë kohës, pasi klienti njëkohësisht merr rrissjet dhe konsumon përsitimet e shërbimeve të dhëna nga Shoqëria. Shoqëria përdor metodën e inputit bazuar në orët e punës/ kostot e shkaktuara në varësi të inputit të pritur total ndaj përbushjes së atij kushti performance, në mënyrë që të vlerësojnë progresin e përbushjes së kushtit të performancës. Ne rastin e prodhimit të programave informatike, njojja e të ardhurave bëhet në një datë të caktuar, e cila përkon me datën e nënshkrimit të certifikatës së pranimit të furnizimit nga klienti, referuar parashikimeve në kontratën përkatësë, pasi në këtë datë shoqëria garanton funksionimin e programit të porositur.

### **Komponent i rëndësishëm i financimit**

Përgjithësisht Shoqëria arketon të drejtat nga klientët në një afat që varion nga 30-90 ditë. Shoqëria nuk skonton vlerën e të drejtave përtuarku përfektin e komponentit të rëndësishëm të financimit nëse parashikon që në momentin e nënshkrimit të kontratës, periudha nga data e marjes në dorëzim të mallit apo shërbimit nga klienti deri në arketimin e shumës nga Shoqëria, do të jetë më e vogël se një vit.

Ne rast të kundert, çmimi i transaksionit për këto kontrata do të skontohej duke përdorur normën e interesit të huamarjes nga bankat e cila reflektohen karakteristikat nëse ky transaksion financimi nëse do ishte i vecante.

Njojja e të ardhurave, përtet e paraqitura më sipër të cilat përbëjnë veprimtarinë kryesore të shoqerisë, është bërë me të njëjtën metodikë edhe përiudhat paraardhëse. Si rrjedhim, aplikimi i IFRS 15, nuk sjell ndryshime në vlerat e të ardhurave të raportuara në periudhat më të hershme duke filluar nga data 01.01.2018.



### **3.3.2 SNRF 9 Instrumentet Financiare**

IFRS 9 parashtron kërkesa për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa kontrata për të blerë ose shitur sendet jofinanciare. Ky standard zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja. Si rezultat i miratimit të SNRF 9, Shoqëria ka miratuar ndryshime konsekutive në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, të cilat kërkojnë që zhvlerësimi i aktiveve financiare të paraqitet në një zë të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përbledhëse.

Shoqëria ka raportuar humbjet nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.

### **3.3.3 SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 Qiratë paraqet një model të vetëm kontabilizimi në bilanc për qiramarrësit. Një qiramarrës njeh një të drejtë për të përdorur aktivin që përfaqëson të drejtën e përdorimit të këtij aktivit dhe njëkohësisht përbën edhe një detyrim qiraje që lidhet me obligimin për të shlyer pagesat e qirasë financiare.

Ka disa përashtime opcionale për qiratë afatshkurira dhe qiratë për mjete me vlerë të vogël. Kontabilizimi për qiradhënësin mbetet shumë i ngjashëm me standardin aktual – për shembull, qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative.

SNRF 16 zëvendëson udhëzuesit aktualë të qirasë duke përfshirë SKK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi në rast se një marrëveshje përban një qira, KIC-15 Qiratë operative – Incentivat dhe KIC-27 Vlerësimi i substancës së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë.

Shoqeria planifikon te aplikonte per here te pare SNRF 16 me 1 Janar 2019, duke përdorur metoden retrospективë te modifikuar. Keshtu që efektet e akumuluara te aplikimit te SNRF 16 do te njihen si një rregullim i balancave hapces te Fitim/Humbjeve te mbartura me 1 Janar 2019, pa patur nevoje per riparaqitje te informacionit krahasues. Shoqeria ka nenshkuar kontrata te qirase te cilat klasifikohen si afatshkurter (deri në 12 muaj) dhe nuk ka opsjon riparteritje të tyre.

Si rezultat aplikimi i SNRF 16 efektivisht nuk sjell efekte financiare në mënyrën e trajtimit të tyre, ndaj shoqeria vijon te raportoje ne llogaritë e Fitim/Humbjeve te vitit, vlerën e shpenzimeve per qiratë operative në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Pavec sa me sipër nuk ka patur standarde apo interpretimet të tjera te reja, të cilat kanë hyrë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 osc pas kësaj date, që të kenë efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë.

## **3.4 STANDARDET DHE INTERPRETIMET E PUBLIKUARA POR EFEKTIVE NË PERIUDHAT VIJUESE**

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2021 ose pas kësaj date, e megjithate Shoqeria nuk i ka aplikuar keto standarde te reja ose te rishikuara ne perqatjen e ketyre pasqyrave financiare si me poshte vijon:

### **Efektive qe prej 1 Janarit 2021**

- Kontratat e Sigurimit SNRF 17
- Shitia ose kontributi ne aktive ndermjet Investitorit dhe Bajes ose Shoqerise se Perbashket (Perditesime ne SNRF 10 dhe SNK 28).

## **4. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE**

Mjetet monetare dhe ekuiivalentët e tyre më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
Vlerat janë paraqitur në LEKE

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Llogari në bankë	<b>113,080,379</b>	<b>104,298,937</b>
Llogari rjedhese ne LEK	42,908,325	80,868,881
Llogari rjedhese ne EUR	61,451,941	19,598,279
Llogari rjedhese ne USD	8,720,114	3,831,777
Para në dorë	<b>112,815</b>	<b>248,949</b>
Ne monedhe vendase	92,537	89,439
Ne monedhe te huaj	20,278	159,510
<b>TOTAL</b>	<b>113,193,194</b>	<b>104,547,886</b>

## 5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Kliente per mallra e sherbime	882,178,207	1,224,107,552
Kliente -palët e lidhura	15,382,015	32,544,365
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	-127,884,955	-12,651,564
<b>TOTAL</b>	<b>769,675,267</b>	<b>1,244,000,352</b>

Te arketueshmet janë pa interes dhe zakonisht me terma pagese nga 30 deri me 90 dite dhe lidhen me shitjen mallrave dhe shërbimeve. Si rezultat i mosarketimit në afat, bazuar në evidencën deri me 31.12.2020 por edhe në arkëtimet e këtyre balancave deri në datën e miratimit të pasqyrave financiare, Shoqëria ka vlerësuar mbi baza individuale dhe kolektive zhvleresimin e llogarive të arkëtueshme sipas modelit te humbjeve te pritshme te kredise per 12 muaj dhe per gjate gjithe jetes, lëvizjet e të cilët janë paraqitur në vijim:

## Zhvlerësimi i debitorëve

	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Balanca me 1 Janar	<b>-12,651,564</b>	<b>-6,539,354</b>
Shtesa e viti	-119,120,548	-6,112,210
Rimarrje e viti	3,887,157	0
<b>Balanca me 31 Dhjetor</b>	<b>-127,884,955</b>	<b>-12,651,564</b>

## 6. INVENTARËT

Inventarët më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Mallra per shitje	86,923,969	183,554,594
Zhvleresimi i mallrave	-17,488,285	-15,854,100
<b>TOTAL</b>	<b>69,435,684</b>	<b>167,700,493</b>

Shoqëria ka njojur mallrat me koston e blerjes se tyre, ndërsa në datën raportuese i ka vlerësuar mallrat me vleren neto të realizueshme minus kostot e vlerësuara te shitjes. Si rezultat Shoqëria ka llogaritur zhvleresimin e inventarit gjate 2020 dhe 2019, i cili paraqitet si më poshtë:



#### Zhvlerësimi i inventarit

	31.12.2020	31.12.2019
Balanca me 1 Janar	<b>-15,854,101</b>	<b>-12,394,053</b>
Shtesa e vitit	-3,017,435	-8,410,733
Rimarrje e vitit	1,383,249	4,950,685
<b>Balanca me 31 Dhjetor</b>	<b>-17,488,285</b>	<b>-15,854,101</b>

Për stokun e vjetëuar, të demtuar, e pa vlerë përdorimi, Shoqëria ka llogaritur zhvlerësim me vlerë -3,017,435 Lekë për vitin 2020 (31.12.2019: -8,410,733 Lekë), ndërsa ka rimarrë zhvlerësimin e njohur në shpenzime, në periudhat e mëparshme, me vlerë 1,383,249 Lekë.

#### 7. KOSTOT E KONTRATAVE TË SHËRBIMIT

Emërtimi	31.12.2020	31.12.2019
Sherbime te blera për rishitje	35,394,039	89,952,321
<b>TOTAL</b>	<b>35,394,039</b>	<b>89,952,321</b>

Kostot e kontratave të shërbimit për rishitje, përfaqesojnë shërbime elektronike të blera nga furnitorët për periudhën maksimale të kontratës me klientin, ndërsa rishitja e tyre tek klientët per gjithësisht ndodh mbi baza një apo tre mujore, sipas parashikimeve të kontratave respektive. Shoqëria ka kontrollin mbi këto shërbime, kontroll të cilin e transferon tek klienti duke i dhënë aksesin elektronik dhe faturuar njëkohesisht në fillim të periudhës së shërbimit.

#### 8. AKTIVE TË KONTRATËS

Aktivet e kontratës më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :

Emërtimi	31.12.2020	31.12.2019
Mallra të derguara tek klientët, pjese e kontratave të shërbimit	89,868,360	204,132,360
<b>TOTAL</b>	<b>89,868,360</b>	<b>204,132,360</b>

Shoqëria ka transferuar mallrat, materialet apo shërbimet e paraqitura në këtë tabelë tek klienti i saj, në funksion të realizimit të dhënies së shërbimeve të kontraktuara, para se klienti të paguajë shumën korresponduese osc para se shuma të jetë e detyrueshme për t'u paguar sipas kontratave. Shoqëria ka paguar tvsh dhe tatim fitimin për to. Mallrat apo materialet e derguara tek klientët, pjese e kontratave të shërbimit, përfaqesojnë furnizime të dorëzuara nga Shoqëria e të pranuara nga klienti, pa të cilat dhënia e shërbimeve elektronike mujore apo tremujore të kontraktuara, nuk është e mundur. Pra këto pajisje mundësojnë kryerjen e shërbimit. Pas dorëzimit Klienti ka kontrollin dhe merr perfitimet nga përdorimi i tyre.

#### 9. TË ARKËTUESHME TË TJERA

Të arkëtueshmet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :



<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Të ardhura të përllogaritura	7,475,812	16,760,747
Parapagimet përfuritorët	18,492,413	10,431,019
Shpenzime të parapaguara	1,152,312	1,371,895
Parapagimet përfuronjësit	15,000	35,000
Parapagim përfur aktive në proces	1,971,208	500,105
Të arkëtueshmë të tjera	5,361,303	8,148,421
Të arkëtueshmë të konstatuara	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>34,468,047</b>	<b>37,247,187</b>

Të ardhura të përllogaritura përfaqësojnë të drejta të arkëtueshme, që i përkasin vitit 2020, por që faturimi i tyre sipas kontratës është kryer në vitin 2021.

Parapagimet përfuritorët lidhen kryesisht me disbursursime në favor të furnitoreve ne lidhje me shërbimet sipas kontravave të perbashkëta (JV) me nënkontraktorë të tjere.

Shpenzime te parapaguara përfaqësojnë faturimet e pranuara nga shoqeria per shërbime që do të konsumohen në vitin 2021.

Ndërsa të arkëtueshmet e tjera përfaqësojnë te drejta nga administratë tatimore me vlerë 4,140,343 Lekë, të provizionuara 100% (shenimi nr.12), si dhe të drejta të tjera nga Debitorët, pjesa më e rendësishme e të cilave është arketuar pas dates se mbylljes së bilancit.

## 10. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<b>Pershkrimi</b>	<b>Pajisje Informatike</b>	<b>Pajisje zyre dhe mobilje</b>	<b>Automjete</b>	<b>Te tjera AAM</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>					
Më 31 dhjetor 2018	31,229,921	8,158,918	5,855,665	6,814,153	52,058,656
Shtesa	2,514,144	290,463		259,689	3,064,296
Pakësimi	(681,659)	(28,334)		(8,409)	(718,402)
Më 31 dhjetor 2019	33,062,406	8,421,047	5,855,665	7,065,433	54,404,551
Shtesa	1,616,140	760,479		59,073	2,435,692
Pakësimi	(76,481)	-		(32,900)	(109,381)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>34,602,065</b>	<b>9,181,526</b>	<b>5,855,665</b>	<b>7,091,607</b>	<b>56,730,862</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>					
Më 31 dhjetor 2018	(19,808,296)	(6,730,303)	(2,256,213)	(4,587,896)	(33,382,708)
Shtesa	(3,145,794)	(301,670)	(719,880)	(463,382)	(4,630,726)
Pakësimi	568,556	24,053	-	7,341	599,950
Më 31 dhjetor 2019	(22,385,534)	(7,007,920)	(2,976,093)	(5,043,937)	(37,413,484)
Shtesa	(2,833,423)	(310,742)	(575,904)	(406,958)	(4,127,027)
Pakësimi	2,052	-		11,608	13,660
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(25,216,905)</b>	<b>(7,318,662)</b>	<b>(3,551,997)</b>	<b>(5,439,287)</b>	<b>(41,526,851)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>					
Më 31 dhjetor 2019	10,676,872	1,413,127	2,879,572	2,021,496	16,991,067
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>9,385,160</b>	<b>1,862,864</b>	<b>2,303,668</b>	<b>1,652,320</b>	<b>15,204,012</b>

Aktivet afatgjata materiale përfaqësojnë aktive të cilat përdoren përfurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe përfurimin e administrative.

## 11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE



 

Llogari të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Llogari të pagueshme të tretëve	228,649,626	441,805,373
Llogari të tjera të pagueshme per sherbime	32,778,892	31,450,955
Llogari të pagueshme palëve të lidhura	120,271,038	198,364,935
	<b>381,699,556</b>	<b>671,621,263</b>

Llogarite e pagueshme nuk mbartin interes dhe paguhën zakonisht brenda 30 deri ne 60 dite.

## 12. DETYRIME TATIMORE DHE TË TJERA

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga :

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Të pagueshme ndaj shtetit	52,057,858	13,187,407
Të pagueshme ndaj punonjësve	11,398,069	12,231,380
Shpenzime të përllogaritura	2,361,818	2,763,599
Provizione për çështje gjyqësore	4,140,343	4,140,343
Të ardhura të shtyra	5,640,568	21,162,704
Kreditorë të tjera	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>75,598,655</b>	<b>53,485,431</b>

Ne muajin janar 2021, shoqeria ka proceduar me likujdimin e detyrimeve te mesiperme ndaj punonjësve dhe ndaj administrates tatimore, të cilat përbëhen si vijon:

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Detyrim per tatim mbi pagë	3,795,066	3,106,395
Detyrim per TVSH	40,498,234	4,936,273
Detyrim per tatim ne burim	5,346,583	2,772,232
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,417,136	2,372,507
Detyrime te tjera	839	-
	<b>52,057,858</b>	<b>13,187,407</b>

Të ardhurat e shtyra me vlerë 5,640,568 Lekë (31 Dhjetor 2019: 21,162,704 Lekë), përfaqësojnë vlerën e shërbimeve të faturuara deri me 31 Dhjetor, pra në fillim të periudhës së shërbimit, por që i përkasin periudhës pas datës 31 Dhjetor, periudhë gjatë së cilës Shoqëria realizon shërbimin dhe identifikon kostot për realizimin e tij, ndërsa klienti përfiton shërbimin dhe përfitimet nga shërbimi.

## 13. DETYRIME KONTRATE

Detyrimet e kontratave më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, të cilat përfaqësojnë vlerat e arkëtuara paraprakisht nga Shoqëria, për porositë e marra nga klientët, të cilat ajo është e detyruar ti përbushë pas dates 31 Dhjetor, përbëhen nga :



<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Parapagime të marra nga klientët për porosi	13,919,256	47,426,924
<b>TOTAL</b>	<b>13,919,256</b>	<b>47,426,924</b>

#### **14. DIVIDENT I PAGUESHËM**

Gjatë vitit 2020 Shoqëria ka paguar të gjithë detyrimin ndaj ortakëve per shperndarjen e pote te fitimit te vitit 2019, krijuar si rezultat i marrjes se vendimit te asamblese se ortakeve per shperndaje te fitimit.

#### **15. HUA ME INTERES NGA PALËT E LIDHURA**

Total i kredisë me interes më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Hua nga TAG Engineering sh.p.k.	38,600,000	14,340,480
Hua nga z. Bledar Dhima	19,300,000	44,504,511
Hua nga z. Grigor Joti	135,100,000	311,531,585
Hua nga z. Armand Shara	0	74,668,544
<b>TOTAL</b>	<b>193,000,000</b>	<b>445,045,120</b>

Shoqëria ka nënshkruar marreveshje kredie afatgjatë me ortakët e saj si dhe palët e lidhura, me qëllim plotësimin e nevojave për financimin e aktivitetit, me normën e interesit vjetor sipas publikimeve tremujore të Bankës së Shqipërisë, për secilën monedhe të finançuar (LEK, USD, EUR). Shoqëria nuk iu ka dhënë garanci huadhdhësve, për këto hua të marra. Normat e interesit të aplikuara janë norma të tregut te huasë.

#### **16. KAPITALI**

Tabela më poshtë tregon strukturën e pa ndryshuar të kapitalit te Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, si vijon:

<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>	<b>Kontributi ne %</b>
Investment Joti - Infosoft Group Sh.p.k.	47,180,000	47,180,000	70%
TAG Engineering Sh.p.k.	13,480,000	13,480,000	20%
Z. Bledar Dhima	6,740,000	6,740,000	10%
<b>TOTAL</b>	<b>67,400,000</b>	<b>67,400,000</b>	<b>100%</b>

Shoqëria gjykon qe kapitali dhe fitimi i krijuar gjatë vitit 2020, është i mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve, angazhimeve financiare korrente dhe kapitale të shoqërisë për periudhën në vijim.

#### **17. TË ARDHURA NGA SHITJET**

Të ardhurat për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,099,699,628	1,074,789,825
Të ardhura nga sherbimet e rishitura	547,868,202	673,672,853
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe sherbimeve	639,555,480	639,438,052
<b>Totali</b>	<b>2,287,123,310</b>	<b>2,387,900,730</b>

#### **18. KOSTOT E INVENTARIT DHE E SHERBIMEVE TE SHITURA**



**Infosoft Systems sh.p.k.**

Pasqyrat financiare të vitit 2020

Vlerat janë paraqitur në LEKE

Kosto e inventarit dhe e sherbimeve të shitura për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Kosto e mallrave dhe sherbimeve të shitura	-1,437,826,473	-1,428,040,108
Bonuse, stimuj dhe zbritle marrë nga furnitorët	28,325,532	42,365,353
Mallra të nxjerra jasht përdorimit	0	-8,231,731
Rimarrje e provizioneve për mallrat jasht përdorimit	1,383,249	4,950,685
Rimbursim i mallrave të humbur/dëmtuar	13,470	866,244
<b>Totali</b>	<b>-1,408,104,223</b>	<b>-1,388,089,557</b>

**19. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE NETO**

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Të ardhura të tjera	1,685,871	6,014,920
<b>Totali të ardhura të tjera</b>	<b>1,685,871</b>	<b>6,014,920</b>
Nxjerra jasht përdorimit e AAM	-51,452	-118,452
<b>Total shpenzime të tjera</b>	<b>-51,452</b>	<b>-118,452</b>
<b>Totali të ardhura/shpenzime operative neto</b>	<b>1,634,419</b>	<b>5,896,468</b>

**20. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shpenzimet e pagës	-147,391,441	-140,133,780
Shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe s	-17,566,083	-15,983,724
Shpenzime për shpërblime	-17,761,274	-11,450,646
Shpenzime trajnimi	-3,713,328	-4,593,999
<b>Totali</b>	<b>-186,432,126</b>	<b>-172,162,149</b>

**21. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE**

Shpenzimet administrative për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
 Vlerat janë paraqitur në LEKE

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shpenzime për donacione për tërmelin 2019	0	-24,000,000
Shpenzime për shërbime nga palët e treta	-20,767,200	-18,972,139
Shpenzime qiraje	-15,913,911	-16,136,515
Shpenzime konsulencë	-11,108,801	-12,366,037
Shpenzime mirëmbajtje	-8,365,510	-7,313,389
Shpenzime përfaqësimi dhe udhëtimi	-1,230,626	-2,467,443
Shpenzime kancelarike, ujë, drita	-3,429,064	-3,630,364
Shpenzime transporti dhe karburanti	-1,803,044	-1,898,219
Shpenzime ligjore	-996,250	-1,155,786
Shpenzime tatimore	-698,418	-701,043
Shpenzime telefoni	-1,108,978	-1,559,580
Shpenzime garancie	-1,351,029	-885,776
Shpenzimet marketingu	-189,398	-3,425,285
Shpenzime ruajtje	-1,318,501	-2,254,480
Shpenzime doganore	-1,045,001	-1,499,665
Shpenzime të tjera administrative	-3,516,555	-1,707,022
Gjoba dhe penalitetë	-254,330	-8,896,808
<b>Totali</b>	<b>-73,096,615</b>	<b>-108,869,551</b>

## 22. SHPENZIMET E ZHVLERËSIMIT

Shpenzimet e zhvlerësimit të aktiveve të shoqërisë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shpenzime per zhvlerësimin e të arkëtueshmeve	-115,233,391	-6,112,210
Fshirja e llogarive të arkëtueshme	0	-1,212,412
Shpenzime per zhvlerësimin e inventarit	-3,017,435	-8,410,733
<b>Totali</b>	<b>-118,250,826</b>	<b>-15,735,355</b>

## 23. KOSTO FINANCIARE NETO

Kostot financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

<b>Emërtimi</b>	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shpenzime interesë	-29,318,777	-25,451,539
Të ardhura nga interesë	201,805	511,532
Komisione bankare	-2,663,527	-2,133,206
<b>TOTAL</b>	<b>-31,780,499</b>	<b>-27,073,213</b>

## 24. FITIMI/(HUMBJA) NETO NGA KURSET E KËMBIMIT

Humbja nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet nga:



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
 Vlerat janë paraqitur në LEKE

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
<b>Emërtimi</b>		
Humbje nga kursi i kembimit	-4,038,809	-3,087,866
Fitimi nga kursi i kembimit	1	1,249,870
<b>TOTAL</b>	<b>-4,038,808</b>	<b>-1,837,995</b>

## 25. SHPENZIMI I TATIM FITIMIT

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet nga:

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
<b>Emërtimi</b>		
<b>Shpenzimi i vitit mbi tatim fitimin</b>	<b>-61,432,262</b>	<b>-65,532,065</b>
Shpenzim/ e ardhur tatimor i/e shtyrë	-	-
<b>Totali</b>	<b>-61,432,262</b>	<b>-65,532,065</b>
 <b>Fitimi para tatimit</b>	 <b>462,927,606</b>	 <b>675,398,652</b>
Totali i shpenzimeve të pazbritshme/Rimarrje provizione	124,863,179	33,979,974
<b>Fitimi i tatushëm</b>	<b>587,790,786</b>	<b>709,378,626</b>
 <b>Shpenzimi i tatim fitimit për vitin (5% &amp; 15%)</b>	 <b>-61,432,262</b>	 <b>-65,532,065</b>
<b>Norma e efektive e tatimit mbi fitimin</b>	<b>13.27%</b>	<b>9.70%</b>
	-61,432,262	-65,532,065

### Levizja e Tatimit mbi Fitimin

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Balanca me 1 Janar	30,273,659	32,228,779
Shpenzimi vitit	-61,432,262	-65,532,065
Pagesa gjate vitit	37,032,811	63,576,945
<b>Balanca me 31 Dhjetor</b>	<b>5,874,208</b>	<b>30,273,659</b>
	5,874,208	30,273,659

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.730 datë 12 dhjetor 2018, Shoqëritë që gjenerojnë të ardhura nga aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, te përcaktuara sipas terminologjisë së Standardeve Ndërkombëtare ISO/IEC 12207:2017, kanë të drejtë të aplikojnë një normë te tatimit mbi fitimin prej 5% për të ardhurat e gjeneruara nga ky proces. Si rezultat Shoqëria ka detyrimin të identifikojë dhe tju sigurojë autoriteve tatimore ndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara nga ky aktivitet dhe pjesën e të ardhurave dhe shpenzimeve që i përket aktivitetit i cili tatohet me normën standarde te tatimit prej 15%. Vlera e tatimit prej -13,368,181 lekë (31 Dhjetor 2019: 20,437,367 Lekë), perfshirë në shpenzimin e tatimit mbi fitimin prej 61,342,262 Lekë që i përket vitit 2020, rezulton nga përllogaritja e tatimit mbi rezultatin tatimor të shitjes së produkteve të teknologjisë IT me një normë tatimi prej 5% në përpunhje me vendimin e cituar me lart. Pjesë përbërëse e këtij shenimi, konsiderohet ANEKSI (25.1) ne vijim për ndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2020 sipas aktiviteteve dhe normave përkatëse të tatimit.

### 25.1 Aneks shpjegues

Për illogaritjen e tatim fitimit per aktivitetet Software dhe aktivitetet e tjera të realizuara gjatë vitit 2020



Pasqyrat financiare janë të përgatitura në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi bazën e kostos historike. Ne kete menyre klasifikimi i zerave të pasqyrave financiare eshte bere bazuar ne SKK-te perkatese. Credit notat, bonuset te cilat jane faturuar tek furnitoret dhe deklaruar ne FDP-te perkatese, jane zbritur nga kosto e mallit te shitur kurse ne kontabilitet ato mbahen tek te ardhurat.

Referuar VKM-se nr.730 dt.12.12.2018, per aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të software-ve, personat juridikë do te aplikejne shkallen tatimore te tatimit mbi fitimin prej 5%. Kjo shkalle tatimore do te aplikohet vetem per ate pjese te aktivitetit qe percaktohet ne VKM, ndërsa per pjesen tjeter te aktivitetit do te aplikohet norma standarde tatimore 15%. Shoqeria ka aplikuar shkallen tatimore 5% per aktivitetet software per pasqyrat financiare te vitit 2020 dhe 2019.

Referuar VKM-së, ne tabelen e meposhtme jane paraqitur te ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga aktiviteti software per te cilin eshte aplikuar shkalla tatimore 5% te ndara vecmas nga te ardhurat dhe shpenzimet e realizuara nga aktiviteti te tjera jo-software per te cilat eshte aplikuar shkalla tatimore prej 15%. Ndaja e ketyre zerave eshte bere bazuar ne tabelen e paraqitur ne vijim sipas mbajtjes se tyre ne kontabilitet. Shpenzimet operative te kompanise jane ndare ne te rrejtjen mase dhe proporcione te te ardhurave nga aktiviteti software kundrejt aktiviteteve te tjera.

Kostot e punes per aktivitetet software, i jane alokuar ketij aktiviteti referuar listes se punonjesve e cila eshte depozituar prane Drejtorese Rajonale te Tatimpaguesve te Medhenj. Pjesa tjeter e kostove te punes i eshte alokuar aktivitetit i cili tashitet me 15%. Te ardhurat dhe shpenzimet e shoqerise jane klasifikuar ne kontabilitet referuar tabeles me poshtë:

	Aktivite software	Aktivite te tjera	Total viti 2020
Te ardhura	945,895,070	1,370,689,278	2,316,584,348
Kosto e mallit te shitur	-474,882,778	-962,188,766	-1,437,071,544
Kosto pune	-159,141,090	-23,577,708	-182,718,798
Shpenzime operative	-32,549,209	-47,166,808	-79,716,017
Amortizimi dhe zhvleresime	-49,403,855	-71,590,747	-120,994,603
Shpenzime financiare	-1,566,704	-2,270,299	-3,837,003
Shpenzime interesit	-11,971,283	-17,347,494	-29,318,777
<b>Fitimi bruto</b>	<b>216,380,151</b>	<b>246,547,454</b>	<b>462,927,606</b>
Shpenzimet e pazbritishme	50,983,452	73,879,728	124,863,179
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>267,363,603</b>	<b>320,427,182</b>	<b>587,790,785</b>
Tatim fitimi 5%	-13,368,181		-13,368,181
Tatim fitimi 15%		-48,064,081	-48,064,081
<b>Fitimi neto nga aktivitetet:</b>	<b>280,731,784</b>	<b>368,491,263</b>	<b>401,495,344</b>

## 26. PALËT E LIDHURA

Në rrjedhën e kryerjes së veprimtarisë operacionale, Shoqëria ka hyrë ne transaksione të ndryshme me palët e lidhura. Palët e lidhura perfshijnë entitete si "ITD shpk", "Interbrands shpk", "IkubInfo shpk", "Inveg shpk" etj. Për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, kanë ndodhur transaksionet e mëposhtme me efekt në pasqyrën e pozicionit finanziar dhe ne Fitimin/ humbjen e vitit, me palët e lidhura si më poshtë:



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
 Vlerat janë paraqitur në LEKE

	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Te pagueshme nga palet e lidhura	(120,271,038)	(198,364,935)
Te arkëtueshme nga palet e lidhura	15,382,015	32,544,365
	<b>(104,889,023)</b>	<b>(165,820,570)</b>

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Hua ndaj paleve te lidhura	193,000,000	445,045,120
Interes I pagueshem ndaj paleve te lidhura	2,297,005	8,688,863
<b>Total</b>	<b>195,297,005</b>	<b>453,733,983</b>

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shijë tek palet e lidhura	5,772,145	38,759,383
Blerje nga palet e lidhura	581,224,998	626,813,976
	<b>586,997,143</b>	<b>665,573,359</b>

#### Kompesimi i Drejtimit

	<b>Viti 2020</b>	<b>Viti 2019</b>
Shpenzime page	11,701,512	11,701,512
<b>Totali</b>	<b>11,701,512.00</b>	<b>11,701,512.00</b>

#### 27. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e eksposuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiare:

- rreziku i kreditit,
- rreziku i likuiditetit,
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj seilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit të shoqërisë. Shënimet sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollot e duhura të rrezikut dhe për të monituar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Instrumentat kryesorë financiare të shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekvivalentet me to, të arkëtueshmet, të pagueshmet, dhe të tjera të pagueshme.

##### (a) Rreziku i kreditit



**Infosoft Systems sh.p.k.****Pasqyrat financiare të vitit 2020**

Vlerat janë paraqitur në LEKE

Rreziku i kreditit është rreziku që palët e treta dhe te lidhura me shoqërinë të mos përbushin detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktuale kundrejt investimit në një instrument finansiar ose llogari të arkëtueshme, duke e shtryrë atë drejt humbjeve financiare. Shoqëria është e ekspozoar ngaj rrezikut të kreditit nga aktivitetet e Shoqerise, duke përfshirë depozita ne banka dhe institucionet financiare.

Rreziku i kreditit menaxhohet nga Shoqëria duke bere vleresime te paleve me te cilat hyn ne marredhenie kontraktuale dhe monitoronit te vazhdueshem te vjetersise se balancave dhe indikatoreve per zhvleresim. Ekspozimi maksimal i rrezikut të kreditimit në datën e raportimit është vlera e mbartur e cdo klase të aktivit finansiar.

Maksimumi i ekspozimit të kreditit në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	113,193,194	104,547,886
Llogari te arketueshme tregtare	897,560,222	1,256,651,916
Aktive te kontratës	89,868,360	204,132,360
Te arketueshme te tjera	33,315,735	37,247,187
Te arketueshme nga tatimet	5,785,393	30,273,659
<b>Total</b>	<b>1,139,722,904</b>	<b>1,632,853,008</b>

**(b) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria do të hasë vështirësi në përbushjen e detyimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mijeteve monetare apo te ndonjë aktivi tjetër finansiar. Qëllimi i shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përbushjen e detyimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në ato të vështira, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të shoqërisë. Shoqëria ekspozimet kryesore ne aktive i ka me entet shtetërore dhe pasivet ndaj paleve të lidhura e të tretëve, per te cilat pret te zbatoje kushte e perkaktuar sipas kontratave.

Në tabelat e mëposhtme paraqiten marrëdhëniet kontraktuale, maturiteti i mbetur i aktiveve finansiarë dhe detyrimet deri më 31 Dhjetor 2020, si vijon:

**Gjendja me 31 Dhjetor 2020**

	deri ne 3 muaj	3 - 12 muaj	Mbi 12 muaj	Total
<b>AKTIVET</b>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	113,193,194			113,193,194
Llogari te arketueshme tregtare	769,675,267			769,675,267
Aktive te kontratës	23,805,000	66,063,360		89,868,360
Te arketueshme te tjera	34,468,047			34,468,047
Te arketueshme nga tatimet	5,785,393			5,785,393
<b>Total Aktive</b>	<b>946,926,901</b>	<b>66,063,360</b>	-	<b>1,012,990,261</b>
<b>DETYRIMET</b>				
Llogari te pagueshme	(381,699,556)			(381,699,556)
Detyrime tatimore dhe te tjera	(75,598,655)			(75,598,655)
Detyrime te kontrate	(3,522,840)	(10,396,416)		(13,919,256)
Hua me interes nga palët e lidhura			(193,000,000)	(193,000,000)
<b>Total detyrime</b>	<b>(460,821,051)</b>	<b>(10,396,416)</b>	<b>(193,000,000)</b>	<b>(664,217,467)</b>
<b>Hendeku-i Likuiditetit</b>	<b>486,105,850</b>	<b>55,666,944</b>	<b>(193,000,000)</b>	<b>348,772,794</b>
<b>Kumulative</b>	<b>486,105,850</b>	<b>541,772,794</b>	<b>348,772,794</b>	<b>348,772,794</b>

Ndërsa me 31 Dhjetor 2019, si vijon:



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
 Vlerat janë paraqitur në LEKE  
**Gjendja me 31 Dhjetor 2019**

	<b>deri ne 3 muaj</b>	<b>3 - 12 muaj</b>	<b>Mbi 12 muaj</b>	<b>Total</b>
<b>AKTIVET</b>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	104,547,886			104,547,886
Llogari te arketueshme tregtare	1,146,483,872	97,516,480		1,244,000,352
Aktive te kontratës	23,805,000	71,415,000	108,912,360	204,132,360
Te arketueshme te tjera	33,106,844		4,140,343	37,247,187
Te arketueshme nga tatiimet	20,649,795	9,623,864		30,273,659
<b>Total Aktive</b>	<b>1,328,593,397</b>	<b>178,555,344</b>	<b>113,052,703</b>	<b>1,620,201,444</b>
<b>DETYSIMET</b>				
Llogari te pagueshme	(628,958,558)	(42,662,705)		(671,621,263)
Detyrime tatumore dhe te tjera	(49,345,088)		(4,140,343)	(53,485,431)
Detyrime te kontrate	(47,426,924)			(47,426,924)
Hua me interes nga palët e lidhura			(445,045,120)	(445,045,120)
<b>Total detyrime</b>	<b>(725,730,570)</b>	<b>(42,662,705)</b>	<b>(449,185,463)</b>	<b>(1,217,578,738)</b>
<b>Hendeku-i Likuiditetit</b>	<b>602,862,827</b>	<b>135,892,639</b>	<b>(336,132,760)</b>	<b>402,622,706</b>
<b>Kumulative</b>	<b>602,862,827</b>	<b>738,755,466</b>	<b>402,622,706</b>	<b>402,622,706</b>

**(c) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin. Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i normës së interesit, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i tregut dhe ndryshimi në emimet e kapitalit.

Analizat e mëposhtme janë përgatitur bazuar në detyrimet neto, në raportin e përqindjes së interesit nga fiks në të luhatshëm dhe në pjesën e investimeve në monedhë të huaj në instrumenta financiar. Menaxhimi është përgjegjës në kontrollin e huave me përqindje interesit fiks të huave me përqindje interesit të luhatshëm.

**Rreziku i normave të interesit**

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 shoqëria ka vetëm detyrime interes-mbajtëse. Detyrimet aktuale lidhen me huatë nga palët e lidhura, kështu që shpenzimet dhe flukset monetare operative mund të ndikohen nga lëvizjet e normave të interesit në treg dhe më specifiksht nga normat interbank të bankave të huaja për monedhën USD dhe EUR por edhe vendase për monedhën LEK.

**Rreziku i kurseve të këmbimit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me luhatje të mundshme në normat e këmbimit përsa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Shoqëria ka teprica të aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj, të cilat e ekspozojnë njësinë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj.

**Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës**

Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2020 është si më poshtë:



**Infosoft Systems sh.p.k.**  
**Pasqyrat financiare të vitit 2020**  
**Vlerat janë paraqitur në LEKE**  
**Gjendja me 31 Dhjetor 2020**

	<b>TOTAL</b>	<b>EURO</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>
<b>AKTIVET FINANCIARE</b>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	<b>113,193,194</b>	61,472,219	8,720,114	43,000,861
Llogari te arketueshme tregtare	<b>769,675,267</b>	240,641,549	70,495,254	458,538,464
Aktive te kontratës	<b>89,868,360</b>			89,868,360
Te arketueshme te tjera	<b>34,468,047</b>	4,015,086	197,336	30,255,625
Te arketueshme nga tatumet	<b>5,785,393</b>			5,785,393
<b>Totali i Aktiveve financiare</b>	<b>1,012,990,261</b>	<b>306,128,854</b>	<b>79,412,704</b>	<b>627,448,703</b>
<b>DETYSIMET FINANCIARE</b>				
Llogari te pagueshme	<b>(381,699,556)</b>	(56,485,934)	(91,037,014)	(234,176,608)
Detyrime tatumore dhe te tjera	<b>(75,598,655)</b>	-	-	(75,598,655)
Detyrime te kontrate	<b>(13,919,256)</b>	(4,015,086)	(197,337)	(9,706,833)
Hua me interes nga palët e lidhura	<b>(193,000,000)</b>	0		(193,000,000)
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>(664,217,467)</b>	<b>(60,501,020)</b>	<b>(91,234,351)</b>	<b>(512,482,096)</b>
<b>Pozicioni Financiar Neto</b>	<b>348,772,794</b>	<b>245,627,834</b>	<b>(11,821,647)</b>	<b>114,966,607</b>

Eksposimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

**Gjendja me 31 Dhjetor 2019**

	<b>TOTAL</b>	<b>EURO</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>
<b>AKTIVET FINANCIARE</b>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj	<b>104,547,886</b>	19,757,789	3,831,777	80,958,320
Llogari te arketueshme tregtare	<b>1,244,000,352</b>	321,234,187	65,460,072	857,306,093
Aktive te kontratës	<b>294,084,681</b>			294,084,681
Te arketueshme te tjera	<b>37,247,187</b>	7,289,371	1,497,830	28,459,986
Te arketueshme nga tatumet	<b>30,273,659</b>			30,273,659
<b>Totali i Aktiveve financiare</b>	<b>1,710,153,765</b>	<b>348,281,347</b>	<b>70,789,679</b>	<b>1,291,082,739</b>
<b>DETYSIMET FINANCIARE</b>				
Llogari te pagueshme	<b>(671,621,263)</b>	(106,448,465)	(35,138,523)	(530,034,275)
Detyrime tatumore dhe te tjera	<b>(53,485,431)</b>	0	0	(53,485,431)
Detyrime te kontrate	<b>(47,426,924)</b>	-	-	(47,426,924)
Hua me interes nga palët e lidhura	<b>(445,045,120)</b>		(57,361,920)	(387,683,200)
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>(1,217,578,738)</b>	<b>(106,448,465)</b>	<b>(92,500,443)</b>	<b>(1,018,629,830)</b>
<b>Pozicioni Financiar Neto</b>	<b>492,575,027</b>	<b>241,832,882</b>	<b>(21,710,764)</b>	<b>272,452,909</b>

**Analiza e ndjeshmërisë**

Në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit shoqëria ka përfshirë zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e shoqërisë. Megjithatë, në periudha afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur me poshtë.

**Analiza e ndjeshmërisë ndaj kurseve të këmbimit**

Analiza e ndjeshmërisë është përcaktuar bazuar në eksposimin ndaj normave të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimeve specifike në fillim të vitit kontabël dhe që mbarten gjatë gjithë periudhës kontabël. Më poshtë paraqiten efektet nga ndryshimet në kurset e këmbimit në fitim/humbjen neto, duke mbajtur konstantë variablat e tjera:



	<b>31.12.2020</b>	<b>31.12.2019</b>
EUR zhvleresohet /mbivleresohet me 10%	+/-24,562,783	+/- 24,183,288
USD zhvleresohet /mbivleresohet me 10%	+/-1,182,165)	+/-2,171,076
<b>Efekti Neto ne Fitim/Humbje</b>	<b>+/- 23,380,619</b>	<b>+/- 22,012,212</b>

## **28. RAPORTIMI I VLERËS SË DREJTË**

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përcaktohet si vlera në të cilin instrumenti mund të shkëmbitet lehtësisht midis palëve të rëna dakort në një transaksion, ne diten e matjes duke i referuar kushteve aktuale të tregut (cmimi i shitjes ne diten e matjes nga perspektiva e pales që zoteron aktivin apo që mbart detyrimin). Kur një cmim nuk eshte i identifikueshem ne treg, Shoqeria mat vleren e drejtë duke perdorur teknika vleresimi që maksimizojnë perdorimin e të dhenave të tjera të identifikueshme ne treg dhe minimizojnë të dhenat e paidentifikueshme. Këto metoda u përdorën për të vlerësuar vlerat e drejta si më poshtë:

- Para dhe depozita afatshkurtra, të drejta të tregtueshme, detyrime të pagueshme dho detyrime të tjera afatshkurtra vleresohen me vlerat e mbartura si pasojë e maturitetit të shkurtër së këtyre instrumentave.
- Huaj interes-imbajtëse me normë të ndryshueshme, përcaktohen sipas normave të interesit të specifikuara në marrëveshjet e huasë. Kështu që më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vlera e mbartur e tyre vleresohet të jetë e njëjtë me vlerën e drejtë të huave të ngashme me karakteristika të ngashme në treg.

## **29. ANGAZHIME DHE PASIGURI**

Shoqeria ka nënshkruar kontrata kredie dhe garancie me bankat dhe të tretët, për të garantuar klientët, furnitorët dhe palë të treta të lidhura per kontrata specifike. Gjate vitit 2020, Limiti i kredisë nuk është përdorur as nga shoqeria dhe as nga bashkëhuamarrësit e tjerë, palë të lidhura. E njëjtë situate edhe per kontratat e garancive. Shoqeria dhe palët e lidhura, pjesë të së njëjtës kontratë me institucionet financiare, nuk kanë patur histori të mospagesave apo ekzekutim të garancive të dhëna.

### **Cështje ligjore**

Shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj është perfshirë në çështje gjyqesore të ndryshme, me cilësinë e paditësit, si ndaj klientëve, autoriteteve publike dhe administratës tatimore, ku efektet financiare sipas gjykimit te manaxhimit te Shoqerise mund te rezultojne ne flukse monetare hyrëse, pasi ajo tashme i ka zhvleresuar te drejtat per 100% te vleres kontabel.

Këto çështje, janë në shkallë të ndryshme të gjykimit dhe per arsyet e voneses se vendimarjes nga ana e sistemit gjyqesor, koha e arketimit te tyre eshte e pasigurtë.

## **30. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Drejtimi i shoqërisë nuk ka identifikuar ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime ose prezantim në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Drejtimi mendon se situata e Covid 2019 nuk do të influencojë në pozicionin finanziar dhe në performancën e Shoqërisë.

